

Të Bëhesh një Dishepull i Jezu Krishtit

MANUALI I SEMINARIT PËR DHIA TËN E RE

Merre kryqin tënd

Lexo te Lluca 9:23, duke kërkuar kërkesat e Shpëtimtarit për të qenë dishepulli i Tij.

- Çfarë mësimi jep ky varg për të qenit një dishepull i vërtetë i Jezu Krishtit?

Ky varg nënkupton kryqin fizik që mbarti Jezu Krishti dhe mbi të cilin vuajti për të përmbushur vullnetin e Atit të Tij. Ndonëse nuk na kërkohet që të mbartim një kryq fizik si ai që mbarti Zoti, nga na kërkohet që ta ndjekim Atë duke e përmbushur vullnetin e Atit Qjellor për ne edhe kur është e vështirë.

Lexoje Përkthimin prej Joseph Smith-it, Mateu 16:26 [tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta] dhe kërko se çfarë do të thotë për ne të marrim kryqin tonë dhe ta ndjekim Jezu Krishtin.

Plaku Ulises Soares, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, shpjegoi se çfarë do të thotë të marrim kryqin tonë.



“Ne mësojmë nga shkrimet e shenjta se ata që duan ta marrin mbi vete kryqin e tyre, e duan Jezu Krishtin në mënyrë të tillë që i mohojnë vetes gjithë paperëndishmërinë e çdo lakmi të botës dhe i zbatojnë urdhërimet e Tij.

Vendosmëria jonë për të mos bërë asgjë që është në kundërshtim me vullnetin e Perëndisë dhe për të sakrifikuar gjithçka që na kërkohet të japim dhe të përpiqemi fort që të ndjekim mësimet e Tij, do të na ndihmojë të durojmë në shtegun e ungjillit të Jezu Krishtit – madje përballë vuajtjes, dobësisë së shpirtit tonë ose trysnisë shoqërore dhe filozofive të botës, që i kundërshtojnë mësimet e Tij.” Ulises Soares, “Ta Marrim Kryqin Tonë”, *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2019, f. 113–114)

- Përse nevojitet t’ia mohosh vetes çdo paperëndishmëri ose lakmi të botës në jetën tënde?
- Në ç’mënyra mund të jetë mohimi i paperëndishmërisë ose i lakmive të botës ndaj vetes njëlloj si mbajtja e kryqit?
- Si mundet të të ndihmojë “marrja e kryqit tënd” të jesh një dishepull i vërtetë i Jezu Krishtit?

Humbe jetën tënde për ta shpëtuar atë

Lexo te Mateu 9:24–25, duke kërkuar për atë që dha mësim Zoti lidhur me të qenit dishepulli i Tij.

- Çfarë na mësojnë këto vargje për të qenit një dishepull i vërtetë i Jezu Krishtit?
- Si mendoni ju, në çfarë mënyrash njerëzit që përqendrohen te vullneti i vet dhe dëshirat e tyre vetjake egoiste përfundimisht do ta “humbas[in]” jetën e tyre?
- Si mendoni ju, çfarë do të thotë që ju do ta shpëtoni jetën tuaj nëse e humbisni për Jezu Krishtin?

Presidenti Tomas S. Monson (1927–2018) shpjegoi se çfarë do të thotë ta humbasim jetën tonë për Jezu Krishtin.



“Ata që jetojnë vetëm për vete vshken dhe në mënyrë figurative e humbasin jetën e tyre, ndërsa ata që e humbasin veten në shërbim për të tjerët rriten e lulëzojnë – dhe në fakt e shpëtojnë jetën e tyre.” (Tomas S. Monson, “Çfarë Kam Bërë për Dikë Sot?” *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2009, f. 85)

- Kë njeh që ka zgjedhur ta humbasë jetën e tij ose të saj për hir të Jezu Krishtit? Çfarë ndikimi ka pasur ky vendim te ky person?
- Në çfarë mënyrash je bekuar për shkak se Jezu Krishti i jetoi mësimet në këto vargje?

Mposhti shpërqendrimet dhe shfajësimet

Lexo te Lluca 9:57–62, duke kërkuar atë që individë të caktuar dëshironin të bënin përpara se ta ndiqnin Shpëtimtarin.

- Çfarë na mësojnë këto vargje për të qenit një dishepull i vërtetë i Jezu Krishtit?

Jezu Krishti nuk tregoi se është e gabuar të vajtosh për vdekjen e një njeriu të dashur ose t'u thuash lamtumirë miqve dhe familjes. Përkundrazi, Ai po u mësonite atyre një mësim të rëndësishëm për koston e dishepullimit.

Presidenti Hauard W. Hanter (1907–1995) shpjegoi analogjinë e plugut te Lluca 9:62.



“Që të gërmojë një brazdë të drejtë [ose kanal], pluguesi ka nevojë që t'i mbajë sytë e tij te një pikë e fiksuar përpara tij. Kjo e mban

atë në një drejtim të saktë. Megjithatë, nëse ndodh që ai shikon prapa për të parë se ku ka qenë, mundësitë e tij për të shkuar në udhë të gabuar, shtohen. Rezultatet janë brazda të shtrembra dhe të parregullta. ... Nëse energjitë tona përqendrohen jo prapa nesh, por përpara nesh – te jeta e përjetshme dhe gëzimi i shpëtimtimit – ne me siguri do ta marrim atë.” (Howard W. Hunter, “Am I a ‘Living’ Member?” *Ensign*, maj 1987, f. 17)

- Cilat janë arsyet e zakonshme që njerëzit mund të japin sot përse zgjedhin të mos e ndjekin Zotin?
- Si mund të qëndrosh i përqendruar tek ajo që Shpëtimtari të ka kërkuar të bësh tani dhe në të ardhmen tënde?